

VENDIM
Nr.39, datë 25.10.2005

PËR KALIMIN NË RISIGURIM TË KLASËS 10 TË SIGURIMIT

Në mbështetje të shkronjave "d" dhe "k" të pikës 2, nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve", nenin 107, 108 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", dekretit nr.295, datë 15.9.1992 "Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë", me propozim të organit ekzekutiv, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Shoqëritë e Sigurimit SIGMA SHA, SIGAL SHA, ATLANTIK SHA, INTERSIG SHA, DUKAGJIN AL SHA, INTERALBANIAN SHA dhe ALBSIG SHA, detyrohen të kalojnë në risigurim portofolin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj personave të tretë (përfshirë kartonin jeshil), brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendim.

2. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit SIGMA SHA, SIGAL SHA, ATLANTIK SHA, INTERSIG SHA, DUKAGJIN AL SHA, INTERALBANIAN SHA dhe ALBSIG SHA, dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 25.10.2005.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba